



MAGAZINE

# ZERI

E ILUSTRUAR

SHQIPTARE

SHITOJCE  
*vetra plus*

PROBLEMORE:

30 MIJË DM PËR  
TË VRARË NJË  
GJYQTAR!!!?



**MONSTRUMI I BALLKANIT NË HAGË**

**REÇAK, 3 KORRIK 2001**

**HAKI XHELADINI: "NË LITAR"!**

**SYLË HALILI: "JO! BURG I PËRJETSHËM;  
QË TA VRASË TRISHTIMI DHE VETMIA..."**

Nr. 1784, 14 korrik 2001

Çmimi: KOSOVË- 1.5 DEM, IMAGEDONI- 63 DEN

## NIPIB "ZËRI"

EDITOR

Blerim SHALA

KRYEREDAKTOR

Halil MATOSHI

REDAKTOR PËRGJEGJËS

Behxhet HALITI

Agron SHALA (aktualitet &amp; shoqëri)

## REDAKSIA:

Dush GASHI

Agim ZOGAJ

Flurim GASHI

Arben IDRIZI

Daut DAUTI

Aida BARAKU

Armend REXHEPAGIQI

Antigona UKA

Naser MEKOLLI

Blerim LATIFI

## BASHKËPUNËTORË:

Ferid SELIMI, Sebahate SHALA, Bekim

MUHAXHIRI, Luljeta TAHIRAJ, Nexhat

TOVËRLANI, Agim FAZLIU

KOLUMNISTË

Muhamedin KULLASHI, Ahmet KELMENDI,

Shemsi KRASNIQI, Valur INGIMUNDARSSON,

Vjollca KRASNIQI

Ramadan BLLACAKU (redaktor teknik)

Idriz ULAJ (lektor)

Skënder RASHITI (korrektor)

Gani HALILI (realizimi kompjuterik)

## KORRESPONDENTËT:

Isuf HAJRIZI (Uashington)

Albana BEQIRI (Tiranë)

Ibrahim MEHMETI (Shkup)

Ekrem KRASNIQI (Bruksel)

Enver ROBELLI (Cyril)

Bahri CANI (Këln)

Përgjegjës për Maqedoni

Nijazi CAMI

## ADRESA:

PALLATI I SHTYPIT (Përmby Sallonin e

Librit), 38000 PRISHTINË, Tel/fax.:

038/549-071, Tel: 549-634, 28-456,

e-mail: zeri\_j@hotmail.com

SHTYPET NË SHTYPSHKRONJËN

"KOHA" NË PRISHTINË



Foto: Hazir REKA/Reuters



Blerim SHALA

## KRIMI

A përfundon lufta me konferenca paqësore?

Kjo pyetje iu qepet natyrshëm pamjeve të Slobodan Milosheviqit në Tribunalin e Hagës, atyre të hapjes së varreve masive të kosovarëve nëpër tërë Serbinë, së fundit, fotografisë ku shihen eshtrat e mijëra boshnjakëve të masakruar në Srebrenicë, para gjashtë vjetësh.

Dënimi i krimit dhe kriminelit nuk është hakmarrje, por është drejtësi, përsëritej pandërprerë nga zyrtarë ndërkombëtarë në ditën kur u dërgua në Hagë Milosheviqi.

Por, a është kjo përbushje e mirëfilltë e drejtësisë?

Lufta mund të përfundojë në një konferencë paqësore, çfarë ishte Daytoni për Bosnjë dhe Hercegovinë e Rambouilleti për Kosovën, gjykimi i Milosheviqit është drejtësi, por edhe vite të tëra, mbase dekada, ne, këndejpari do të ballafaqohemi me pasojat e luftës dhe me konsekuencat e krimeve të bëra nga regjimi i Milosheviqit të cilat mund të dënohen, por nuk fshihen dot me kurrfarë verdikti.

Ta zëmë, në rastin e Kosovës, fajësia e Beogradit zyrtar është e qartë. Tashmë, kjo po bëhet transparente me hapjen e varreve masive nëpër tërë Serbinë, e cila është shndërruar në arkipelag të varreve shqiptare. Kunti i krimeve po vjen prej atyre që s'mund të flasin dot: prej të vrarëve. Por, nëse regjimi i tashëm serb ka bërë hap të guximshëm me hapjen e varrezave dhe me informimin e opinionit për krime, ajo çfarë ka ndodhur në Kosovë, nuk mund të ketë vetëm një adresë faji dhe përgjegjësie: Slobodan Milosheviqin. Përmasat e krimeve në Kosovë janë të tilla që kërkojnë një ballafaqim të krejt politikës serbe dhe të opinionit serb me këto krime. Nuk po flasim as për fajësi dhe as për dënim kolektiv, por për ballafaqim kolektiv i cili duhet të shprehet në të gjitha instancat politike, intelektuale dhe shpirtërore serbe. As fajësia dhe as shfajësia nuk mund t'i atribuohet vetëm regjimit. Nuk pastrohet ndërgjegjja vetëm me dërgimin e Milosheviqit në Hagë dhe nuk mund të pretendohet normalizimi i raporteve me popujt fqinjë sall me gjykimin politik në Beograd dhe atë të mirëfilltë, në Hagë, të krimeve të regjimit të mëparmë serb. Regjimi i tashëm serb, herët a vonë, duhet të kuptojë se krimet e bëra në Kosovë i kanë dhënë fund çfarëdo ideje të bashkëjetesës së Kosovës dhe Serbisë në një shtet të përbashkët. Pajtimi midis shqiptarëve dhe serbëve duhet të bëhet dhe ai mund të bëhet pas ballafaqimit me krimin të opinionit serb dhe me normalizimin e raporteve në të gjitha rrafshet midis shtetit të Kosovës dhe atij të Serbisë. □



# UNIVERSITETI NË VENDET NË TRANZICION DREJT KAPITALIZMIT DHE DEMOKRACISË

Shkruan: RORY J. CONCES

## I. HYRJJE

a) "Në mbrojtje të universitetit" ka qenë një moto në shërbim të lirisë akademike brendapërbrenda universitetit. Kjo është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për akademikët anëmbanë botës. Një shprehje, një moto tjetër është edhe "Në mbrojtje të edukimit". Kjo ka të bëjë me mbrojtjen si të një pikëpamjeje të veçantë për universitetin, ashtu edhe mbi një model të edukimit që është i lidhur me ndërtimin e një personaliteti të formuar dhe me ndërtimin e një kombi e shoqërie civile të fuqishme. Kjo pikëpamje dhe ky model kanë një afinitet të natyrshëm si për demokracinë - si një sistem politik, ashtu edhe për demokracinë të kuptuar si një "stil jetësor, si një mënyrë e të jetuarit".

## II. UNIVERSITETI DHE EDUKIMI

a) Pikëpamja e zakonshme për universitetin bashkëkohor. Tre komponentët

1. Universiteti është një institucion burokratik ku personeli, resurset dhe vendimmarrja është e ndarë nëpër departamente, ky sistem operon përmes vendimeve të udhëhequra nga rregullat rigjide. Mbrojtja e interesave të një departamenti këtu bëhet po aq e rëndësishme, nëse jo madje më e madhe, se sa interesat e institucionit në përgjithësi.

2. Ky është një institucion me një hierarki të një autoriteti të zhvilluar, një autoriteti i cili lëviz prej Rektorit të Universitetit, drejt dekanëve të fakulteteve, shefave të katedrave, profesorëve e deri tek stafi tjetër.

3. Ky është një institucion i cili vazhdon të nxisë ideale dhe gjurmime drejt së vërtetës, mirëpo gjithnjë më shumë po orientohet drejt krijimit të aftësive praktike dhe punëtorëve të kualifikuar. Jo vetëm kualifikimet me të cilat pajisen individët, të cilët dëshirojnë të gjejnë punë sa më të mirë në treg, por edhe prosperiteti shoqëror i një vendi po varet gjithnjë e më shumë nga fakti se si arsimohen shtetasit e tij. Udhëheqësit politikë dhe ekonomikë të vendeve në tranzicion drejt kapitalizmit e demokracisë do të jenë gjithnjë e më shumë në trysni që ta ndjekin këtë trend.

b) Modeli i Edukimit që vie si pasojë e kësaj pikëpamjeje mbi Universitetin

1. Modeli Edukativ i Enës Mbajtëse apo Bankës së të Dhënave:

Këtu marrëdhënia ndërmjet profesorit dhe studentit është e



ngjashme me marrëdhënien ndërmjet kamarierit dhe klientit: ashtu si kamarieri, që ka për detyrë t'ia mbushë klientit gotën me birra, ashtu edhe profesori është aty që ta mbushë studentit me "dituri". Për më tepër, profesori çmohet si një figurë plot autoritet të cilën ai asnjëherë nuk e vë në pyetje, dhe prej tij nuk mëson vetëm "përbajtjen", por edhe "mënyrën" e prezentimit të mësim-it. Studenti është një "enë" e cila duhet të mbushet nga profesori. Në kohën e provimit, studenti e "derdh" dijen kur kjo kërkohet nga ai, në të njëjtën mënyrë si, kjo dije, iu është dhënë më parë atij.

2. Rolet e profesorit dhe të studentit:

Profesori është i stërvitur të bëhet shkencëtar (dhe atij në masë të madhe i ofrohet posti në bazë të veprimtarisë së tij hulumtuese), kështu që roli kryesor i profesorit është ai i hulumtuesit. Roli i mësimdhënësit pra ka rëndësi të dorës së dytë. Roli i studentit është ai i nxënësit, i dikujt që në mënyrë pasive pret që profesori ta pajisë më dituri. Kjo është edhe një referencë tjetër mbi studentit si një "enë". Për më shumë, kjo marrëdhënie është quajtur si "marrëdhënie kontraktuale", ku studenti kontraktton që ai vetë të vijë në klasë, kurse profesori ta pajisë me dituri. Regjistrimi në këtë kurs është marrëveshja. Studenti është si pala përfituese ashtu edhe pala e obliguar në këtë marrëveshje. Në të njëjtën kohë studenti nuk ka fuqi që të ndikojë në udhëheqjen, apo mbi planprogramet e Universitetit.

c) Këto qëndrime janë të zakonshme në krejt botën.

1. Janë të zakonshme në shtetet kapitaliste të demokracisë liberale, si p.sh SHBA dhe Britani e Madhe.

2. Gjithashtu mund të gjenden edhe në shtetet komuniste-socialiste, si Kina dhe Kuba dhe në shtetet në tranzicion si Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.

d) Pikëpamjet Alternative lidhur me Universitetin dhe Edukimin.

1. Edhe pse Universiteti është institucion burokratik, këtu lejohet një fleksibilitet thelbësor duke theksuar dhe forcuar kanalet e komunikimit midis shtresave të ndryshme prej të cilave përbëhet universiteti dhe duke vendosur një qasje "marrjesh dhe dhëniesh" gjatë marrjes së vendimeve. Interesi i "departamenteve" të tjera dhe i institucionit në përgjithësi merret parasysh shumë seriozisht.

2. Është vështirë të paramendohet një institucion i cili nuk ndërthet në vete një strukturë autoriteti. Edhe në këtë model alternativ të universitetit ekziston një formim hierarkik, por këtu ekziston një prani e dialogut dhe e kompromisit gjatë marrjes së vendimeve. Struktura e këtij institucioni ka më shumë formën e një rrjete se sa atë të një strukture shtresa-shtresa.

3. Formimi i aftësive të studentëve (duke përfshirë këtu edhe aftësimin për të gjetur punë) është një funksion i rëndësishëm i universitetit bashkëkohor. Por, elementet e "formimit të personalitetit" nuk mund të barazohen gjithmonë me ato të formimit të

aftësive dhe kualifikimeve për treg. Për më shumë, nëpër shtetet e zhvilluara demokratike-kapitaliste si dhe për shtetet në tranzicion, ekziston edhe detyra e ndërlidhur e ndërtimit dhe e zhvillimit të kombit dhe shoqërive civile.

4. Këtu, në këtë model alternativ të edukimit ekziston një raport interaktiv gjatë të cilit prezantimi i materialit bëhet në atë mënyrë që t'i lejojë studentit që ta bëjë të vetin, ta përvetësojë atë mësim. Ky proces mundësohet si qasje "interaktive", që do të thotë se ekziston një përzjerje midis ligjëratave, diskutimeve dhe pyetjeve-përgjigjeve. Barriera midis profesorit dhe studentëve dobësohet.

5. Roli i profesorit këtu qëndron më shumë në statusin e mentorit, i cili përpiket ta lehtësojë procesin e mësimin. Puna hulumtuese në këtë model është e rëndësishme, por kjo nuk guxon të tërheqë fokusin prej mësimdhënies. Roli i studentit pëson ndryshime, sepse atij jipen më shumë përgjegjësi gjatë procesit mësimor. Kjo qasje interaktive mund të funksionojë vetëm nëse që të dyja palët marrin pjesë, participojnë në të. Kjo është një qasje aktive. Gjithashtu ky model përshkohet nga një "marrëveshje besimi", gjatë të cilit edhe profesori edhe studenti i kanë përgjegjësitë e veta. Pasi që në këtë qasje nuk kemi të bëjmë vetëm me marrje informatash, gjë që mund të bëhet edhe pa praninë e profesorit, është më rëndësi që profesori ta kuptojë edhe rolin e tij në këtë proces. "Orët e zyrës" po që se janë të shpeshta janë shenjë se profesori e kupton rolin e tij si mentor. Në rastin ideal, të dyja palët përfitojnë. Gjithashtu studentit i jepen të drejta që të marrë pjesë në procesin vendimarrës në çështjet e udhëheqjes apo të hartimeve të planprogrameve të universitetit.

### III. TRANZICIONI MIDIS KËTYRE DY PIKËPAMJEVE:

a) Qëllimi është që të bëhet kalimi i Universitetit në një institucion të bashkëpunimit të ngushtë, ku bëhet një proces mësimor interaktiv dhe i përgjegjshëm, i cili synon ndërtimin e personalitetit, shoqërisë civile dhe ndërtimin e kombit. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm, veçanërisht për shtetet që janë në procesin e tranzicionit drejt sistemit kapitalist dhe demokracisë liberale.

b) Demokracitë i kushtojnë kujdes të veçantë edukimit, duke përfshirë këtu edhe edukimin e lartë.

1. Pragmatisti amerikan John Dewey (1859-1952), në veprën "Koncepti demokratik në edukim", jep dy arsye për këtë.

1). Qeveria që bazohet në përkrahjen popullore d.m.th. ajo e cila zgjedhet nëpërmes votave, mund të jetë e suksesshme vetëm nëse njerëzit të cilët e zgjedhin dhe e dëgjojnë qeverinë



**Dr. Rory J. Conces është asistent profesor i filozofisë në Universitetin Nebraska-Omaha (USA). U lind në East Chicago, Indiana (USA). Ai u laurua në Filozofi dhe Psikologji në Uiversitetin Creighton, kurse u doktorua në Universitetin Missouri-Kolumbia. Ai është gjithashtu ligjërues i filozofisë në Universitetin Creighton, ku ligjëron kurset e Mendimit Kritik, lëndë kjo që kërkohet prej të gjithë studentëve të Administratës së Biznesit.**

**Dr. Conces ka shkruar punime nga filozofia e shkencës, estetika, etika, filozofia politike dhe Mendimi Kritik. Monografia e tij për zgjidhjen e konflikteve dhe për filozofinë aplikative: "Vizionet e mjegulluara: filozofia, shkenca dhe ideologjia në botën e trazuar" u botua më 1997. Lëmi i interesimeve të tij në kohët e fundit kanë qenë çështjet mbi mbrojtjen e specieve, çështjet etike dhe çështjet e këmbimeve kulturore. Dr. Conces në verën e vitit 2000 ligjëroi Filozofinë Aplikative në Universitetet Zhongshan dhe Hangzhou në Republikën e Kinës, kurse aktualisht është bursist i fondacionit Fulbright në Universitetin e Sarajevës, ku do të ligjërojë filozofinë aplikative dhe zgjidhjet e konflikteve.**

**Në Universitetin e Nebraskës-Omaha ka ligjëruar lëndët e etikës, problemet aktuale të moralit, filozofi sociale, filozofi politike, mendim kritik dhe logjikë.**

**Dr. Conces është kryesues i programit të Universitetit Omaha lidhur me Konferencën e 24 Nacionale për Studimet e Botës së Tretë. Gjithashtu është edhe redaktor i revistës "Gazeta ndërkombëtare për studimet e botës së tretë".**

janë të arsimuar. Këta qytetarë të arsimuar kërkojnë shumë më shumë përgjegjësi nga qeveria e tyre.

II) Demokracia është në radhë të parë një "mënyrë e të jetuarit si bashkësi, e një përvoje komunikimi të përbashkët". Demokracia qëndron në zgjerimin e një kujdesi të bashkëndarë midis nesh, si dhe në çlirimin e aftësive sa më të llojllojshme të individit. Edukimi i përforcon dhe e zgjeron individualizimin më të madh, si dhe interesat e bashkësisë më të gjerë.

### IV. FORMIMI I PERSONALITETIT: "UNË" DHE "TJETRI"

a) Një veçori e formimit të personalitetit është përpjekja që ai të bëhet sa më autonom që është e mundur, d.m.th. përpjekja që të përcaktohet çka do të duhej të bëjmë në jetën tonë (Robert Paul Woolf, "Në mbrojtje të anarkizmit", 1971). Kjo gjë "qëndron në përpjekjet shtesë në marrjen e diturive, në reflektimin mbi motivet, në parashikimin e rezultateve, në qëndrimin kritik ndaj parimeve etj". Kjo përfshin përdorimin e aftësive mendore kritike. Detyra për t'u bërë autonom është e bazuar në pasjen e vullnetit të lirë dhe të aftësisë për të gjykuar.

1. Të jesh i përgjegjshëm për aksionet tuaja-përkundër marrjes

së përgjegjësi për veprimet tuaja.

b) Veçoria e dytë e zhvillimit të personalitetit përfshin refleksionet morale dhe gjykimet. Moraliteti që nuk përcillet nga mendimi kritik paraqet në fakt vetëm brohoritje pa tru e sloganeve të ndryshme, kurse të menduarit kritik që nuk ka moralitet në vete mund ta sjellë ligësinë njerëzore, krimin.

c) Veçoria e tretë e zhvillimit të personalitetit paraqitet nëpërmes dijenisë që ne si qenie njerëzore "kemi fuqi ta bëjmë vetveten ashtu siç duam ne" (Kant dhe Sartre).

d) Edukimi në përgjithësi dhe universiteti në veçanti mund të jetë shumë funksional në pajisjen e individit si me aftësitë dhe kualifikimet, ashtu edhe me marrëdhëniet mentorale, që janë të nevojshme për formimin e personalitetit.

1. Kanti mendonte se edukimi është një proces nëpërmes të cilit njeriu bëhet njeri. Njeriu duhet ta krijojë vetveten nëpërmes veprimeve të veta. Njeriu duhet ta bëjë vetveten qenie morale, racionale dhe me vullnet të lirë. Kjo veprimtari kreative ndodh përgjatë gjithë kohës.

### V. NDËRTIMI I KOMBEVE: TË NDRYSHUARIT E DALLIMEVE DHE TË KONCEPTIT PËR TJETRIN

a) Formimi i personalitetit i kthehet nderimit të kombit dhe shoqërisë civile atëherë kur synimi për t'u bërë më autonom paraqet një mundësi për ndryshimin e koncepteve mbi dallimet



midis njerëzve si dhe ndryshimet e konceptit të Tjetrit. Një mundësi e këtillë mund të vendoset nëpërmes edukimit liberal (që kundërshon trajnimet "profesionale"), i cili përfshin një komponent interkulturore.

b) Martha Nussbaum ("Kutivimi i njerëzores", 1997):

1. Edukimi liberal përpiqet të krijojë individë të lirë. Ky edukim e çliron individin për një qytetari aktive duke e çliruar mendjen e studentit, duke i ndihmuar atij që të arrijë një distancë kritike nga bindjet e trashëguara apo të dhëna, bindje këto që shpesh krijojnë ndarje midis nesh si qytetarë.

l) Siç thekson Allan Bloom në veprën "Mbyllja e mendjes amerikane" (1987), "Liria e mendjes kërkon jo vetëm, apo jo vetëm ekskluzivisht, mungesën e detyrimeve legale, por edhe praninë e mendimeve alternative. Tirania më e suksesshme nuk është ajo që përdor forcën për ta arritur uniformitetin, por ajo e cila e bllokoi vetëdijësimin mbi ekzistencën e mundësive të tjera, tirani e cila e bën të pakapshëm mendimin se edhe rrugët e tjera janë të mundshme, tirani e cila e mënjanon vetëdijen e rrugëdaljes, e shpëtimin nga aty.

2. Mendimi kritik shpie deri tek disiplinimi i interesave vetjake dhe disiplinimi i interesave të një grupi të ngushtë. Ky mendim bën të mundur përfshirjen edhe të qëndimeve të të tjerëve si pikë-pamje që gjithashtu meritojnë respekt.

l) Nuss Baum: "Po që se një person fillon t'i shohë rivalët e tij jo si krejtësisht të huaj dhe si të Tjerë, por si bashkëndarës të disa qëllimeve dhe synimeve të përbashkëta njerëzore... ky konceptualizim do të ndikojë në pakësimin e mllëfit dhe në fillimin e një komunikimi racional.

3. Empatia (të bashkëndierit...vërejtje e përkthyesit) kultivohet si studim i etniciteve, racave, kulturave, gjinive të tjera, dhe si një punë në drejtim të të kuptuarit qytetar, dhe në të njëjtën kohë duke bërë kontestimin e "urtësive tashmë të pranuar"

4. Tjetra do të ndjellë kuriozitet dhe afërsi më shumë sesa do të ndjellte armiqësi

l) Dewey në "Koncepti demokratik i edukimit" thënon: "Nuk është e mjaftueshme vetëm t'i mësojmë njerëzit mbi tmerret e luftës dhe të shmangim gjithçka që mund të nxisë armiqësi dhe xhelozri ndërkombëtar. Thëksi duhet të jetë në atë që i afrohet njerëzit së bashku në synimet dhe arritjet e tyre të përbashkëta, pavarësisht nga pengesat gjeografike. Të kuptuarit e sovranitetit kombëtar, si diçka që i çliron dhe i plotëson marrëdhëniet midis qenieve njerëzore, duhet të vendoset si një dispozitë vepruese e mendjes... ky përfundim i afrohet edhe vetë idesë së edukimit si një çlirim i potencialeve individuale në një rritje progresive, dhe i drejtuar kah qëllimet shoqërore".

5. Në analizat përfundimtare kjo shndërrohet në një "shtegtim shpirtëror", ngase i zbulon vlerat e shpirtit njerëzor-durimin, tolerencën, dashurinë, bashkëndierjen, faljen, satisfaksionin, ndjenjën e përgjegjësive; një ndjenjë të harmonisë- e cila sjell lumturi. Ajo çka i bashkon këto vlera është një shkallë e "kujdesit, e brengës për të tjerët". Ne nuk duhet të veprojmë vetëm si pasojë e brengës për të tjerët, por ne duhet ta transformojmë vetveten në mënyrë që të jemi të disponuar, që me gatishmëri ta bëjmë këtë. T'i zgjerojmë "sferat e përgjegjësive".

l) Dalai Lama shkruan për kultivimin e përgjegjësive universale, e një përgjegjësie që përfshin "një riorientim të mendjes dhe zemrës sonë jashtë nga vetja dhe drejt të tjerëve. Të zhvillosh një përgjegjësi universale- të një dimensionit universal të secilit akt vetjak si dhe të një të drejte të barabartë të të gjithë të tjerëve për lumturi dhe mospasje vuajtjesh- do të thotë të zhvillosh një qasje të mendjes, ku kur shohim një rast nga i cili mund të përfitojnë të tjerët, kësaj do t'i japim përparësi në raport me kujdesin që kemi vetëm ndaj interesave tona të ngushta" ("Etika për Mileniumin e RI", 1999). □


(Autori është asistent profesor i filozofisë në Universitetin Nebraska-Omaha (USA)

Përktheu: Besnik DOMI

# VËREJTJA E FUNDIT PËR NEFAIL MALIQIN

BERNER ZEITUNG BZ

Si e ndëshkoi Shoqata e Korrespondetëve të OKB-së në Gjenevë (ACANU) "gazetarin" e "Bota Sot"?



Pak para referendumit në Zvicër mbi armatosjen e ushtarëve të këtij vendi në botën e jashtme, gazeta "Bota Sot" botoi një "intervistë" me ministrin zviceran të mbrojtjes, Samuel Schmid. Reagimi i Ministrisë pas publikimit të tekstit ishte i ashpër. Autori i "intervistës", Nefail Maliqi, i kishte mveshur disa deklaratatë ministrit, të cilat ai, siç u njoftua më vonë, nuk i kishte thënë asnjëherë. Ministria njoftoi se autori e kishte "mashtuar" ministrin, ndërsa ky kishte rënë në kurth, pasi që nuk e kishte ditur se me çfarë "gazetari" kishte të bënte. U tha se sikur Schmid ta kishte ditur, kurrë nuk do të kishte ndërruar një fjalë me Maliqin.

Fillimisht u duk se skandali po merr fund me këtë reagim nga Berna. Mirëpo, botimi jokorrekt i "intervistës" me ministrin Samuel Schmid ka nxitur një epilog në selinë e OKB-së në Gjenevë. Tomasz Surdel, korrespondenti i gazetës së renomuar polake "Gazeta Wyborcza" nga Varshava dhe zëvendës-president i Shoqatës së Korrespondetëve të OKB-së në Gjenevë (ACANU) ka konfirmuar se në mbledhjen e asociacionit, që është mbajtur në fillim të këtij muaji në Gjenevë, është vendosur që Nefail Maliqi t'i bëhet një vërejtje. Në rast të shkeljes së përsëritshme të rregullave të sjelljes së gazetarit ai mund të përjashtohet nga ACANU, ka deklaruar Surdel. Rrjedhimisht ai do të humbte edhe akreditimin në OKB. "Pa leje pune Maliqi do të duhej ta braktiste Zvicrën", ka njoftuar Ruedi Christen nga Ministria e Jashtme në Bernë. □